



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.980/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kica dhe Adnan Konushevci anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Suharekës, Bulëza Kuçi, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Suharekë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.980/2021 i datës 04.11.2021, i kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Suharekës, Bulëza Kuçi, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Suharekë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumrimin në vendvotimet: 2410A/01R, 2420A/01R, 2407A/01R, 2424A/02R dhe 2417A/01R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.980/2021, i ushtruar nga Bulëza Kuçi, kandidate për Kuvend Komunal, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën ka pretenduar se në vendvotimet: 2410A/01R, 2420A/01R, 2407A/01R, 2424A/02R dhe 2417A/01R, ka familjar dhe miq të cilët i kanë pohuar se e kanë votuar, por nuk i kanë dalur votat. Po ashtu pretendon se anëtarët e KVV-ve kanë manipuluar me votat e kandidatëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidatja për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Bulëza Kuçi, kërkon rinumrimin e votave në vendvotimet e

lantcekura. Paneli pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga apellesja Bulëza Kuçi, është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për manipulim të rezultateve, i njëjti nuk ka ofruar prova të mjaftushme, deklarata, formular, apo ndonjë provë tjetër bindëse, që do të dëshmonin ndonjë parregullësi në vendvotimet e lantcekura. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatojë se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë prove.

Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja

Anr.980/2021 më datën 07.11.2021



Kryesues i Panelit

Zyhdi Haxiri

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.